

Nr. Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më _____.____. 2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PAS PROCESIT TË ANKIMIT)

Drejtuar: “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” sh.p.k, NIPT J61905015B, me adresë: Vaqarr, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur - mallra - me mjete elektronike.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-04916-09-09-2021.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje mjet lundruar për pastrimin e biefit të sipërm nga akumulimet e materialeve dhe mbetjeve urbane për HEC Fierzë”.

Kohëzgjatja e kontratës: 30 ditë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.119 datë 13.09.2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “GTS-Gazra Teknike Shqiptare” sh.p k, NIPT J61905015B, me ofertë ekonomike 29,400,000 (Njëzetë e nëntë milionë e katërqind mijë) Lekë pa TVSH;

2. Operatori ekonomik “Naim 2020” sh.p.k, NIPT M02417012V, me ofertë ekonomike 27,000,000 (Njëzetë e shtatë milionë) Lekë pa TVSH;

Është skualifikuar oferta e operatorit ekonomik “Naim 2020” sh.p.k, NIPT M02417012V, pasi:

✚ Data e regjistrimit të këtij Operatori Ekonomik, sipas ekstraktit të QKB është data 17/12/2020, pra ka me pak se një vit aktivitet. Xhiroja vjetore për vitin 2020, sipas vërtetimit të paraqitur është 5,000,000 lekë, pra nuk e përmbush vlerën e kërkuar në kriterin e kushteve të veçanta pika 2.2.1.

✚ Për plotësimin e pikës 2.3.1 faturat e paraqitura, janë fatura elektronike. Nëse i kontrollon duke skanuar kodin e tyre në faqen e tatimeve rezulton se mungojnë disa informacione.

✚ Për plotësimin e Pikës 2.3.1, përvoja me sektorin publik demonstron me anë të një Marrëveshje Kuadër me objekt: “Shërbim pastrimi i baseneve të liqeneve” çka nuk ka lidhje me furnizim mallrash, siç është kontrata e cila prokurohet.

✚ Për plotësimin e Pikës 2.3.1, përvoja me sektorin privat, vërtetohet me anë të faturave elektronike për materiale metalike, kodi i të cilave nuk skanohet për më tepër detaje. Gjithashtu dhe me faturë tatimore për mbjellje pemësh dhe sistemime dhe faturë tjetër për varkë druri me vlerë vetëm 1000 ALL.

Në total dëshmitë për punë të ngjashme nuk përmbushin kriterin sipas pikës 2.3.1 as për nga vlera as për nga ngjashmëria e objektit të prokurimit.

✚ Për plotësimin e Pikës 2.3.3, inxhinieri mekanik është me kontratë shërbimi për periudhën e tenderit si rrjedhojë nuk figuron në listëpagesat e kërkuara korrik/gusht 2021.

✚ Për plotësimin e Pikës 2.3.3, për punonjësin e kërkuar me profil elektromekanik, është paraqitur një kontratë pune ku pozicioni është nëpunëse zyre/IT/ Elektriçist si dhe punë të tjera sipas nevojave. Në CV rezulton me arsim të mesëm. Ndërkohë, ka një dëshmi kualifikimi për sigurimin teknik, lëshuar më datë 29/09/2021.

✚ Për plotësimin e Pikës 2.3.4 të KVK nuk ka Çertifikatë ADR.

✚ Për plotësimin e Pikës 2.3.7, ka paraqitur një deklaratë me komente referuar këtij kriteri si me poshtë:

- Mjetet që do të furnizojë, do të jenë prodhim i vitit 2021 dhe me kilometrazh 0 (mjetet lundruese nuk kanë kilometrazh sikurse ju parashikoni, si makinat me goma), në rast se shpalleme fitues dhe nënshkruaj kontratë me AK, brenda afateve që parashikohet, sipas dokumentacionit të paraqitur. Afati për dorëzimin e mallit, do të jetë 30 ditë nga data e prodhimit të mjetit, pasi ju e kërkon me kilometrazh zero dhe prodhim të vitit 2021. AK ka specifikuar afatin 30 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

- Garantojmë servis të specializuar për riparimin e mjeteve (ju keni 1 mjet dhe jo disa mjete) objekt prokurimi gjatë periudhës së garancisë (në dokumentet e tenderit nuk keni të parashikuar asnjë periudhë garancie, si dhe tek procesverbali i argumentimit, nuk keni asnjë sqarim teknik dhe ligjor për garancinë, çfarë duhet të ketë servisi, çfarë përfshin etj, si dhe ky prokurim është blerje malli dhe jo prokurim shërbimi).

Referuar komentit të OE që nuk është parashikuar asnjë periudhë garancie, AK ka specifikuar garancinë teknike prej 12 muaj në DST.

Në rast se do të ketë nevojë për servis (këtu nuk përfshihet keqmenaxhimi i mjetit nga AK, gjatë kësaj periudhe, por vetëm difekte në rast se do të jetë për faj të prodhuesit, kjo e provuar me fakte dhe prova), marrim përsiper dërgimin e mjetit dhe riparimin e tij nga prodhuesi, sipas dokumentacionit të paraqitur në tender, ose në ndonjë servis që merret me këtë fushë.

✚ Operatori Ekonomik nuk ka deklaruar emër servisi, siç kërkohet në DT, Kushtet e Veçanta për Kualifikim, pika 2.3.8.

✚ Tek Grafiku i Lëvrimin është ndryshuar afati si më poshtë: 30 (tridhjetë) ditë nga data e prodhimit të mjetit ndërkohë në DST është cituar 30 (tridhjetë) dite nga nënshkrimi i kontratës.

✚ Në Pikën 2.3.6 të KVK, kërkohet skeda teknike, ku specifikimet teknike të mjetit që ofertohe të jenë në përputhje me kërkesat e AK. Në skedën teknike dërguar nga operatori ekonomik nuk përputhet fuqia e motorit. Fuqia e motorit të kërkuar nga AK është 90 Hp, ndërkohë fuqia e motorit të ofertuar nga operatori ekonomik "Naim" 20 sh.p.k është 55 kW, e cila konvertuar në HP është 73.76 HP. Mjeti i ofertuar, gjithashtu, nuk e ka të cilësuar në skedën teknike kapacitetin e rezervuarit të motorit të naftës. Kapaciteti i kërkuar nga AK është 100L. AK ka kërkuar gjithashtu që mjeti të ketë të përfshirë krah fshirës, ndërkohë që mjeti i ofertuar nga OE "Naim 20" sh.p.k nuk e ka të cilësuar në skedën teknike nëse ka të përfshirë apo jo krahun fshirës.

✚ Në shtojcën 4, lista e informacionit konfidencial është shënuar si konfidencial i gjithë informacioni duke ndryshuar tekstin në shtojcë. Është hequr pjesa si më poshtë: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve,

katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “GTS-Gazra Teknike Shqiptare”, NIPT J61905015B, me adresë Tiranë, Vaqarr, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 29,400,000 (Njëzetë e nëntë milionë e katërqind mijë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë KESH sh.a, me adresë: Rr. “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa : PO (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë).

Vendimi përfundimtar i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1027/2021 datë 22/12/2021.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ergys Verdho